

VENDIM
Nr. 108, datë 26.6.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“BESTA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “KUCOVA 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2
mw**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pikat 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Besta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Kucova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw, të kësaj shoqërie.

konstatoi se:

Shoqëria “Besta” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 394 prot., datë 10.6.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Kucova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

Shoqëria “Besta” sh.p.k. ka depozituar në ERE shkresat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 8643 prot., datë 14.6.2018 dhe nr. 8643/2 prot., datë 17.8.2018, nga e cila rezulton se kjo e fundit, ka aplikuar pranë kësaj ministrie për pajisje me “Miratim paraprak”.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresat sipërcituar, i drejtohet shoqërisë “BESTA” sh.p.k duke i komunikuar se pranon aplikimin e saj për pajisjen me miratim paraprak në zbatim të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, e ndryshuar.

Aplikimi i shoqërisë “Besta” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë pjesërisht;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.4.3, germa “c”; pika 4.4.4, germat “d”) është plotësuar në pjesërisht.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Neni 9, pika 2, germa “f” marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës; germa “g” dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Neni 9, pika 4.4.1 Të dhënat teknike për centralet fotovoltaike.
- Neni 9, pika 4.4.2 Të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin.
- Neni 9, pika 4.4.3 Dokumentacioni teknik dhe grafik, germa “a” Paraqitje e përgjithshme skematike të centralit A1; germa “b” Një diagram elektrik në format A1 të agregateve dhe bllokut të

transformimit ku të evidentohet qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes; germa “d” Një hartë topografike ku të paraqitet qartë gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1:25000.

- Neni 9, pika 4.4.4 Dokumentacioni tekniko-ekonomik, germa “a” Studimi i fisibilitetit teknik; germa “b” Grafiku i zbatimit të projektit; germa “c” Oponenca teknike e projektit.

- Neni 9, pika 4.4.5 Leje nga institucione të tjera, germa “a” Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes; germa “b” Leje mjedisore nga organet përkatëse;

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Besta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Kucova 2”, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 20-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti